



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 71, Datë 16 / 3 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 156, datë 07.12.2017, të bërë nga: K.M, R.Z dhe B.K, banorë tek ish “Konvikti i Shkollës Bujqësore”, kundër Bashkisë Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes të Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaroi se: *“Jemi një grup banorësh që jetojmë tek konvikti i ish-Shkollës Bujqësore. Gjendja është alarmante sepse na kanë prerë furnizimin me energji elektrike dhe kanë njoftuar se do ndërpresin dhe furnizimin me ujë. Na kanë njoftuar që të lidhim matësa të veçantë për çdo familje për furnizimin me energji elektrike që kushton rreth 20.000 lekë, ndërkohë që të ardhurat ekonomike janë minimale²”.*

Në përfundim, ankuesit kërkojnë, lidhjen e furnizimit me energji elektrike dhe suvencionimin nga ana e Bashkisë Korçë për vendosjen e matësave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet*

¹ Banoret i përkasin komunitetit rom/egjiptian të qytetit Korçë.

² K.M trajtohet me pagesë KMCA, R.Z trajtohet me ndihmë ekonomike në masën 4320 lek për katër persona dhe B.K trajtohet me ndihmë ekonomike.

politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjektet ankues, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtua shqyrtimit të plotë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1202/1, datë 15.12.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjekteve, Bashkia Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga ankueset: K.M, R.Z dhe B.K.

Me kërkesën datë 22.12.2017, ankueset K.M, dhe B.K janë tërhequr nga ankesa e bërë për vendosjen e matësave pasi kanë deklaruar se kanë paguar matësat dhe kanë lidhur kontratë me OSHEE për furnizimin me energji elektrike.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 38, datë 20.02.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Bashkinë Korçë dhe në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Bashkisë Korçë, më datë 27.02.2018, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit në Bashkinë Korçë morëm takim me K.K me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë i cili sqaroi se Bashkia Korçë për çështjen objekt inspektimi do informonte Komisionerin në rrugë shkresore. Ndërsa në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë, inspektorët e KMD-s, morën takim me R.P, me detyrë Drejtore e Komanduar e institucionit që nga data 15.12.2017.

Gjatë inspektimit R.P informoi se: *“Nga ana e ndërmarrjes për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018 nuk ka patur njoftim për banorët për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Banorët e konviktit janë ndihmuar nga ana e Bashkisë Korçë duke i hartuar të gjithë banorëve projektin elektrik të banesës pa pagesë si dhe duke i pajisur me autorizim për vendosjen e matësave të rinj apo transferimin e matësave për banorët që kanë patur kontratë me OSHEE-n. Gjatë vitit 2017, banorët e konviktit jo në mënyrë të rregullt, kanë bërë çdo muaj pranë ndërmarrjes nga një pagesë prej 500 lekësh për shpenzime të energjisë elektrike dhe ujit”.*

Me shkresën nr. 808/2, datë 09.03.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Korçë, në mes të tjerash ka informuar se: *“Për shkak të realizimit të projektit “Rikonstuksioni i Pazarit të Vjetër Korçë”, familjet rome që banonin tek Hani i Pazarit u transferuan për banim tek ish Konvikti i Shkollës Bujqësore deri në sistemin përfundimtar të tyre në një ambient tjetër. Nga ana e Bashkisë Korçë, për të ndihmuar këto familje i është vënë në dispozicion ambienti i banimit nëpërmjet kontratave të huapërdorjes, i është bërë falas projekti për rrjetin elektrik ndërsa në lidhje me kontratat e furnizimit me ujë të pijshëm, nëse familjet kategorizohen në një nga pikat e nenit 2 të VKM-s nr.18, datë 12.01.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe vendosjen e matësave të ujit për kategoritë në nevojë”, lidhja e kontratës dhe vendosja e matësit do ti bëhet falas me subvencionim, sipas përcaktimeve ligjore”.*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Në mbështetje të provave të administruara, rezultoi se, në datë 10.11.2016, mes Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes të Bashkisë Korçë dhe R.Z është lidhur Kontratë Huapërdorje me qëllim dhënien në përdorim të përkohshëm dhe pa kundërshtim e dhomës nr.1 për qëllim strehimi.

Në pikat 7 dhe 8 të nenit 4 të kësaj kontrate, përcaktohet se: 7:“*Familjari të paguajë faturën e energjisë elektrike dhe faturën e konsumit të ujit të pijshëm*” dhe 8:“*Familjari është i detyruar të lidhë kontratë me OSHEE sha dhe UKKO sha Korçë*”.

Referuar dokumenteve të administruara nga palët vërtetohet se pagesa e faturave të konsumit të energjisë elektrike dhe ujit për periudhën që nga lidhja e kontratave me banorët dhe deri në fund të vitit 2017 për të gjithë godinën e ish konviktit është bërë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes të Bashkisë Korçë, ndërsa banorët në mënyrë individuale dhe jo të rregullt kanë kryer pagesa për konsumin e energjisë elektrike dhe ujit pranë ndërmarrjes së sipërcituar në masën prej 500 lek për energjinë elektrike dhe 500 lek për konsumin e ujit të pijshëm.

Nga shqyrtimi i dokumenteve vërtetohet se R.Z si banore e ish konviktit të shkollës bujqësore megjithë detyrimin e përcaktuar në kontratë për të gjithë periudhën e vitit 2017 nuk ka lidhur kontratë me OSHEE për furnizimin me energji elektrike dhe kontratë me UKKO për furnizimin me ujë të pijshëm.

R.Z pavarësisht se është në vështirësi financiare dhe trajtohet me ndihmë ekonomike, bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike duhet të lidhë kontratë me OSHEE sha, për tu furnizuar me energji elektrike dhe pastaj të përfitojë nga skemat lehtësuese për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, lidhur me kushtet lehtësuese që do të zbatohen ndaj konsumatorëve familjarë të cilët ekzekutojnë detyrimet e prapambetura. Në të njëjtën kohë R.Z duhet të lidhë kontratë dhe me ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime Korçë për furnizimin me ujë të pijshëm, kontratë e cila bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.18, datë 12.01.2018, pika 2/1, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike subvencionohet nga shteti.

Mbështetur nga informacioni i administruar nga Bashkia Korçë, vërehet se nga ana e Bashkisë Korçë, për gjatë gjithë vitit 2017 janë marrë masa për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe ujë të të gjithë banorëve të ish konviktit të shkollës bujqësore si dhe janë ndihmuar të gjithë banorët për hartimin pa pagesë të projektit të rrjetit elektrik për çdo banesë. Në këtë rast konstatohet se dhe familja e R.Z është trajtuar në mënyrë të barabartë me të gjithë banorët e tjerë.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se referuar nenit 7, pika 1³, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i R.Z në raport me banorët e tjerë, pasi veprimet e Bashkisë Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm të banesës së R.Z për shkak të racës.

Referuar deklaratës me shkrim të bërë nga ankueset: K.M dhe B.K, në të cilën deklarojnë se heqin dorë nga pretendimet e tyre, Komisioneri bazuar në nenin 94/1 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në të cilën parashikohet: “Si rregull, në

³ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, vendosi ndërprerjen e procedurave hetimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 94/1 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases R.Z, për shkak të racës, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes të Bashkisë Korçë.
2. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e çështjes për K.M dhe B.K.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: raca)

(fusha: te mira dhe shërbime)